



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Shkurt 2022

Nr: 93

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E MATERIALEVE ZGJEDHORE QË DO TË PËRDOREN PËR  
IDENTIFIKIMIN ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME  
VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së Zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 14 pika 2, nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe nenit 99, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 5, shkronja “e”, të vendimit nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S I N :

1. Në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022, të përdoren kodet e sigurisë dhe kodet rezervë për mbylljen e çdo komponenti të brendshëm dhe/ose porte komunikimi fizike të pajisjeve elektronike të identifikimit të zgjedhësve (PEI), si dhe të përdoren kodet e sigurisë dhe kodet rezervë për mbylljen e valixhes me të cilën transportohet PEI, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Lealba PELINKU**

**Ilirjan CELIBASHI**



**Specifikimet teknike Kode Sigurie PEI & PEVN**

Kodet e sigurisë me Barcode, të cilat lejojnë procesim dhe gjurmim të shpejtë dhe të sakte të të dhënave. Thjeshtëzim në përmbylljen dhe dorëzimin e dokumentacioneve dhe procesverbaleve.

Specifikimet e kodeve të sigurisë

Specifikimet teknike të vulave me kod sigurie që do të përdoren për mbylljen e kompartimenteve dhe valixhes së PEI-t në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2021.

Për kompartimentet e brendshme

Tipi	Pull-up, one-time lock / metal insert
Materiali	Polypropylene (PP) me mbyllje metalike
Procesi fabrikimit:	One-step molding
Gjatësia	230mm (±10%) - gjatësia operationale 150mm
Diametri	2 mm
Madhësia etiketës (rectangular printable area)	37mm x 18mm
Fortësia Tensile	>350N
Ngjyra	Çdo ngjyrë për kontrast të lartë të bar kodit (e bardhë e verdhë) e ndryshme nga kodet e brendshme
Printimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>laser print / QR barcode / 6 numra serial / Tekst KQZ / Logo KQZ</li> </ul>

Për valixhen e transportit

Tipi	Pull-up, one-time lock / metal insert
Materiali	Polypropylene (PP) me mbyllje metalike
Procesi fabrikimit:	One-step molding
Gjatësia	330mm (±10%) - gjatësia operationale 250mm
Diametri	2 mm
Madhësia etiketës (rectangular printable area)	37mm x 18mm
Fortësia Tensile	>350N
Ngjyra	Çdo ngjyrë për kontrast të lartë të bar kodit (e bardhë e verdhë) e ndryshme nga kodet e brendshme
Printimi	<ul style="list-style-type: none"> <li>laser print / QR barcode / 6 numra serial / Tekst KQZ / Logo KQZ</li> </ul>